- Cultural Heritage Without Borders <http://chwbkosovo.org/full.php?id=1260280202&archive=&subaction=showfull&template=full>
- EcoNETT, Rrjeti i Komunitetit Evropian për Udhëtimet dhe Turizmin Mjedisor. <http://www.wtfc.org/>
- Këshilli i Evropës për Fshatra dhe Qytete të Vogla (ECOVAST) <http://www.ecovast.org/english/index.htm>
- Europa Nostra <http://www.europanostra.org/>
- Rrjeti i Trashëgimisë Kulturor [http://www.european-heritage.net/sdx/herein/european\\_heritage\\_program/showcontent.xsp?id=2](http://www.european-heritage.net/sdx/herein/european_heritage_program/showcontent.xsp?id=2)
- Instituti Getty Conservation <http://www.getty.org>

edu/conservation/

- Duke përfshirë: buletin e Institutit Getty Conservation: <http://www.getty.edu/conservation/resources/newsletter.html>
- HELM <http://www.helm.org.uk/>
- ICOMOS <http://www.icomos.org>
- ICOMOS Australia <http://australia.icomos.org/>
- ICCROM <http://www.iccrom.org>
- Lista e organizatave të trashëgimisë në Evropë <http://www.heritage-organisations.eu/page?&orl=1&ssn=&lng=2&pge=2>
- Lajmet e Landscape Character [www.landscapecharacter.org.uk](http://www.landscapecharacter.org.uk)
- Organizata e Qyteteve të Trashëgimisë Botërore Kulturore <http://www.ovpm.org/main.asp>
- Rrugët drejt Peizazheve Kulturore [www.pcl-eu.de](http://www.pcl-eu.de)
- UNESCO <http://www.unesco.org/>
- Qendra e Trashëgimisë kulturore e UNESCO-s <http://www.unesco.org/whc/>
- Kulturë/Konflikt/Bashkëpunim WAC [www.cultureconflictcooperation.com](http://www.cultureconflictcooperation.com)
- Banka Botërore <http://web.worldbank.org/>
- Organizata Botërore e Turizmit <http://www.world-tourism.org/>

#### Faqet e internetit: Debatet

- Shkathësitë themelore të debatit [http://www.actdu.org.au/archives/actein\\_site/basicskills.html](http://www.actdu.org.au/archives/actein_site/basicskills.html)
- Debatë në shkollë (Learning and Teaching Scotland) <http://www.ltscotland.org.uk/debatinginschools/index.asp>
- Faqja e internetit për debat botëror <http://worlddebating.blogspot.com/p/topics.html>

#### Faqet e internetit: Kosovë

- Mision i OSBE-së në Kosovë <http://www.osce.org/kosovo/81075>
- Përkrahja e BE/KE-së për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë (PDKK) [http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/kosovo/default\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/kosovo/default_en.asp)
- Kuvendi i KE-së: Mbrojtja e trashëgimisë kulturore në Kosovë <http://assembly.coe.int/Documents/WorkingDocs/doc04/EDOC10127.htm>

## 7. PUNIME QË VLERËSOHEN

### 7.1. HYRJE

Studentët duhet t'i bëjnë dy punime për vlerësim gjatë semestrit. Mundësit për punime mund të jenë të ndryshme, duke filluar nga hartimi i drejtpërdrejtë i eseve, e deri te punimet më 'aventuriere'. Këtu nuk paracaktohet asgjë, pasi që profesori do të duhet të bëjë zgjedhje të kujdesshme në bazë të kërkesave të universitetit, madhësisë së grupit, interesave të tyre dhe mënyrës së zhvillimi të lëndës me kalimin e javëve. Mundësitë e cekura më poshtë do të duhej t'u jepnin profesorëve një numër idesh, me të cilat do të mund të punonin. Nëse klasa është entuziaste, ata mund të zgjedhin të marrin projekte shtesë që nuk vlerësohen.

### 7.2. MUNDËSITË PËR PUNIMET QË VLERËSOHEN

#### 7.2.1. Tituj e sugjeruar të eseve

Zgjedhni një ese nga temat vijuese:

- Çka është trashëgimia? Përshkruani dhe diskutoni mënyrat, përmes të cilave përkufizohet dhe atribuohet trashëgimia;
- Diskutoni konceptin e vlerave dhe mënyrën se si formohen ato. Cila është rëndësia e tyre në të kuptuarit dhe ruajtjen e trashëgimisë? Si mund t'i ekuilibroni vlerat me potencial kundërshtues në procesin e menaxhimit të trashëgimisë?
- Diskutoni konceptet e trashëgimisë materiale dhe jomateriale dhe mënyrën se si ndërlidhen me njëra-tjetrën. A mund të përkufizohen dhe të menaxhohen në mënyra të njëjta?
- Përshkruani një studim rasti të përdorimit të arkeologjisë në fuqizimin e etnicitetit/ identitetit apo nacionalitetit modern;
- Në cilat mënyra kartat, legjislacioni dhe udhëzimet evropiane apo të pushtetit lokal mund t'i kontribuojnë kornizës për menaxhimin e trashëgimisë?
- A është përfshirja e komuniteteve lokale e rëndësishme në menaxhimin e trashëgimisë? Nëse po, çka do të mund të bëhej në inkurajimin e pjesëmarrjes së tyre?
- Turizmi kulturor është fenomen global në rritje. Diskutoni ndikimin e tij në menaxhimin e trashëgimisë.
- Cilat janë kufizimet që mund të ndikojnë mënyrën e konservimit të vendit apo të peizazhit dhe të interpretimit për qytetarët? Mundësisht jepni ca shembuj;

- Cilat janë përparësitë e diverzitetit kulturor dhe si mund të ruhen ato?

Këto aktivitete duhet të bëhen së paku tri javë pas fillimit të semestrit, deri kur disa nga konceptet bazë do të kenë përfunduar së diskutuari, dhe duhet të kryhen deri në javën 11, në mënyrë që të mund të kthehen dhe të notohen deri në fund të semestrit.

#### 7.2.2. Portofoli i trashëgimisë dhe i diversitetit

Studentët ftohen të krijojnë qëllimet personale dhe t'i paraqesin ato, si dhe përparimin e tyre drejt arritjes së atyre qëllimeve. Për këtë punim ata mund të përdorin fotografitë e bëra nga vetë ata, gazetatat, fotografitë e revistave, punimet me shkrim apo cilindo medium tjetër të qasshëm. Vëmendja ndaj tematikave të ndryshme të lëndës është e rëndësishme thelbësore në këtë ushtrim.

Që nga fillimi i ligjërimit të lëndës, studentët ftohen që vetës t'ia parashtrorjnë pyetjet vijuese:

- Cilat kanë qenë mendimet e tyre për trashëgiminë në fillim të ligjërimit të lëndës? Çka shpresojnë të mësojnë nga kjo lëndë?
- Në çfarë përkrahje do të kenë qasje për arritjen e këtyre qëllimeve?
- Si rezultat i ligjërimit të lëndës, si do ta ndërlidhin njohurinë e fituar me fushën e tyre themelore të interesimit?
- Cilat metoda do t'i përdorin që këtë njohuri t'ua shpërndajnë miqve, kolegëve studentë apo komuniteteve të tyre lokale? Kjo duhet të përcaktohet në javën 1 në mënyrë që studentët të mund të punojnë në të gjatë semestrit.

#### 7.2.3. Fotografia

Studentët mund të bëjnë fotografi:

- Të çdo gjëje që e konsiderojnë si trashëgimi në rrethinën e tyre para se të fillon ligjërimi i lëndës: këto fotografi mund të futen në portofolin e cekur më lartë.

Ose

- Të ndonjë gjëje që e konsiderojnë si trashëgimi në mjedisin e tyre para fillimit të ligjërimit të lëndës dhe një gjë tjetër pas përfundimit të ligjërimit. Fotografitë duhet të përcjellën nga një ese kritike, ku do të shpjegohej se si kanë ndryshuar ose zgjeruar idetë e tyre si rezultat i vijimit të kësaj lënde. Në fund të semestrit këto fotografi do të mund të vireshin si ekspozitë e studentëve.

## 8. PUNIMET E PROJEKTIT QË NUK VLERËSOHEN

### 8.1. HYRJE

Kjo punë parashihet të realizohet qoftë në sesionet praktike apo jashtë orëve të mësimi. Disa studentë mund të dëshirojnë të sfidojnë vetveten më shumë, duke realizuar punime të tjera të projektit gjatë fundjavave ose gjatë pushimeve.

### 8.2. MUNDËSITË PËR PUNIME QË NUK VLERËSOHEN

#### 8.2.1. Fjalori i lëndës mësimore

Puna praktike e modulit mund të fillon me ushtrimin e krijimit të fjalorit, i cili do të mund të vazhdonte gjatë tërë semestrit. Studentët ndahen në grupe të vogla (3-5 persona), dhe të takohen rregullisht. Ata i shënojnë fjalët dhe konceptet që kanë mësuar gjatë një ore të caktuar apo fjalët që mendojnë se ndërliken me temën, si dhe fjalët që nuk i kuptojnë sa duhet...

Pyetjet e parapara për të nxitur të menduarit kritik në mes të tjerash janë si në vijim:

- Cilat fjalë janë kryesoret për ta?
- Si do t'i përkufizonin secilin nga këto koncepte grupet?
- A ka ndonjë dallim apo ngjashmëri?
- A ka ndonjë koncept tjetër që do t'ia shtonin listës?
- Çfarë lloj përkrahje është në dispozicion për përparimin e të kuptuarit të tyre?

Herë pas here njëri grup do të mund t'ua paraqiste të tjerëve fjalorin e tyre, duke shpjeguar çdo fjalë, term apo koncept. Në fund të ligjërimit të lëndës, këta fjalorë në mes të tjerash do të mund të shiheshin si një "dëshmi fizike" e përparimit të studentëve në procesin e studimit të trashëgimisë dhe të diversitetit.

Një nga rezultatet e këtij ushtrimi do të duhej të ishte të kuptuarit se nuk ekziston një përkufizim i vetëm i koncepteve, siç është kultura apo trashëgimia. Domethëniet gjithnjë ndryshohen dhe janë subjektive, ku si rrjedhojë çdo vit do të prodhojë rezultate të tjera. Profesorit do të duhet që me kujdes t'i ndërmerret diskutimet, duke inkurajuar pyetje të menduara mirë dhe pranimin e mendimeve të ndryshme.

#### 8.2.2. Vlerësimi praktik i trashëgimisë

Studentët mund të njoftohen me format zyrtare të vlerësimit të trashëgimisë, p.sh. duke analizuar formularin për nominim për regjistri-

min në lisën e UNESCO-s të vendeve botërore të trashëgimisë, dhe duke realizuar një ushtrim në klasë për krijimin e "nominimit" për një vend në Kosovë.

#### 8.2.3. Diskutim dhe baza formale të të dhënave

Çështja e praktikalitetit të udhëheqjes së diskutimeve apo debateve joformale kryesisht varet nga numri i studentëve që do ta vijnë atë lëndë. Disa lëndë zgjedhore në Universitetin e Prishtinës kanë 20-30 studentë, ndërsa lëndët më të popullarizuara kanë deri në 70-80 studentë. Në rastin e parë do të ishte lehtë që të ndahen studentët në dy grupe (p.sh. 10-15 në secilin grup); megjithatë kjo do të ishte vështirë me numër më të madh të tyre. Numri i studentëve po ashtu është i lidhur me rrezikun e përdorimit të fjalëve jo të mira në debat – sa më i madh të jetë numri i studentëve, aq më i madh është rreziku.

Me siguri do të ishte më së miri që debati të udhëhiqet përgjatë vijave konvencionale dhe formale: p.sh.

- Përmes caktimit të temës. P.sh: "kjo shtëpi propozon se trashëgimia është resurs i ripërtëritshëm";
- Përzgjedhni tre folës për të qenë në ekip "Në favor" të mocionit dhe tre në ekipin "Kundër" tij;
- Anëtarët e ekipit vendosin në mes vete se cilat argumente do t'i përdorë secili person;
- Çdo person flet 5 (?) minuta;
- Votat merren nga audienca, në favor apo Kundër, për të përcaktuar se cili ekip ka fituar.

Studentët mund të debatojnë dhe të këmbëjnë njohuritë e sapofituara me studentët e fakulteteve dhe disiplinave të tjera. Diskutimet mund të përfshijnë vendin dhe përdorimin e trashëgimisë brenda degëve të tjera profesionale, siç është arkitektura, mbrojtja e mjedisit, e drejta, historia, arti, etj.

#### 8.2.4. Revista e studentëve

Studentët mund të shqyrtojnë blogimin në internet për atë se çka kanë mësuar apo të shtypin një revistë në fund të semestrit për të raportuar se çka janë duke bërë.

## 9. AKTIVITETET DHE LOJËRAT

---

Kjo është përzgjedhja e aktiviteteve që do të mund të propozoheshin për sesione praktike të Modullit. Ato nuk janë të parapara që të vlerësohen, por të plotësojnë një vister të nevojave dhe qëllimeve të tjera:

- thyerja e barrierave dhe njohja e pjesëmarrësve me njëri-tjetrin;
  - ndërtimi i ekipit;
  - Stimulimi i diskutimit apo mundësimi i diskutimeve për tema nganjëherë shumë të vështira në një mjedis shumë joformal;
  - Inkurajimi i vrotimit dhe i sesioneve të pyetjeve;
  - Këmbimi i njohurive dhe përvojave të ndryshme për trashëgimitë e ndryshme;
  - Kalimi nga teoria e ligjëratave në praktikë;
  - Krijimi i materialeve që do të mund të përdreshin për kontaktime me qytetarë;
  - Madhërimi i trashëgimisë dhe i diversitetit të saj.
- 



## 9.1. 9.1. AKTIVITETET PËR REALIZIM GJATË LIGJËRIMIT TË LËNDËS

### “Trashëgimia ime”

Çdo pjesëmarrës shkruan në letër një gjë që e konsideron si pjesë të rëndësishme të trashëgimisë së tij. Përgjigja duhet të jetë e shkurtër, dhe nuk ka nevojë të përfshijë çdo gjë rreth trashëgimisë. Pjesëmarrësit duhet të inkurajohen që të përdorin imagjinatën sa më shumë që të jetë e mundur, dhe të kuptojnë se kjo mund të përfshijë trashëgiminë jomateriale dhe atë materiale. Ata nuk duhet të diskutojnë mes vete, dhe do t'u jepen disa minuta për të menduar.

Pasi ta kenë bërë këtë, u shpjegohet se ata nuk duhet të identifikojnë personin në grup që ua ka thënë gjënë më të ngjashme. Çdo person ia lexon grupit se cili është objekti i tyre i trashëgimisë, pa dhënë shpjegime, dhe pastaj grupo ndahet në çifte. Gjërat e identifikuara mund të mos jenë saktësisht të njëjta, por mund të jenë pjesë e tematikës. Nëse ka gjëra që nuk përputhen fare, kjo nuk është problem: ato prap mund të hynë në çifte. Lehtësuesi mund të ketë nevojë të ndihmojë nëse kemi të bëjmë me grup të madh, pasi që personave mund t'u vijë vështirë që të punojnë në çifte.

Çdo çifti i jepen 10-15 minuta për t'ia shpjeguar njëri-tjetrit se pse kanë shkruar atë që kanë shkruar. Pastaj, grupi formon një rreth, dhe çdo person ia paraqet grupit idetë e personit tjetër në çift.

Thyerja e akullit/të mësuarit e dëgjimit të të tjerëve/stimulimi i diskutimit/rifuzimi i solidaritetit për gjërat e përbashkëta apo për çështjen e përbashkët

NB. Ky ushtrim është provuar në punëtorinë e Bolsenas në Itali (në gusht 2011), dhe pjesëmarrësit e kanë kaluar me kënaqësi. Grupi prej 24 anëtarëve ka qëndruar bashkë, dhe i tërë ushtrimi ka zgjatur pothuajse dy orë. Ky ushtrim ka rezultuar të jetë i suksesshëm. Në rastet kur temat kanë qenë të ngjashme, pjesëmarrësit kanë qëndruar në grupe prej 3 personash. Në disa raste punonjësit e KE-së është dashur të ndihmojnë në përkthime.

Në pjesën përfundimtare, pjesëmarrësit u angazhuan shumë, duke shtuar përvojat e tyre në diskutim dhe duke i krahasuar shënimet. Puna ka qenë mjaft e relaksuar, dhe pjesëmarrësit thanë se fakti se u është dashur t'ia shpjegojnë grupit idetë e njëri-tjetrit ishte ushtrim shumë i dobishëm në të mësuarit e dëgjimit dhe të kuptuarit të ideve ose përvojave të ndryshme.

### Përkufizimet

Grupi ndahet në grupe më të vogla prej 5 ose 6 anëtarësh, ku secili merr një pjesë të rëndësishme të lëndës dhe shqyrton përkufizime të ndryshme të saj, p.sh. trashëgiminë, kulturën, diversitetin, universalizmin, etj.

Çdo individ më pastaj duhet të zgjedh diçka që përfaqëson konceptin, në të cilin kanë punuar në një mënyrë kreative: kjo mënyrë mund të jetë lojë, skulpturë, pikturë, objekt apo edhe një këngë. Të gjithë pjesëmarrësit bashkohen dhe çdo grup bënë prezantimin.

- a) përfundimet e tyre lidhur me përkufizimin e termit dhe
- b) 5-6 shembujt dhe shpjego zgjedhjet e tyre.

Ngashëm me ushtrimin më lartë, përveç se ka më shumë punë në ekipe, dhe kërkon më shumë nga aspekti intelektual. Ndërsa ushtrimi i lartshënuar (2) do të ishte shumë i mirë për fillim të shpjegimit të lëndës, ky ushtrim do të mund të përdorej më vonë pasi që konceptet të bëhen më të njohura. Njëkohësisht krijon respekt për pikëpamjet e çdo grupi.



### Shfrytëzimi i mjedisit përreth si një rast historie për analizë.

Ky ushtrim mund të jetë i ngjashëm me ushtrimin më lartë, përveç se fillon duke dërguar grupin në një zonë në afërsi, në mënyrë që ata të analizojnë se çka nënkupton trashëgimia për ta. Kjo zonë nuk duhet domosdo të jetë një mjedis historik: në fakt, do të ishte më mirë që të mos jetë. Duke dalur në rrugë të zakonshme të qytetit, pjesëmarrësit do të inkurajohen që gjërat e zakonshme t'i shikojnë në një mënyrë të re, gjegjësisht, të kërkojnë domethënie nga ajo që shohin çdo ditë. Pas kthimit të tyre në klasë, mund të zhvillohet ushtrimi i cekur më lartë.

Shfrytëzimi i mjedisit si përkrahje për arsim/thyerje të akullit/për të mësuar se si t'i dëgjojmë të tjerët/stimuluar diskutimin/fuqizimin e solidaritetit për gjërat apo çështjet e përbashkëta.

### Muzika botërore

Studentët dëgjojnë 30 minuta lloje të ndryshme të muzikës (zakonisht muzikë tradicionale nga mbarë bota). Pastaj flasin për emocionet e njeri-tjetrit që i përjetuan gjatë dëgjimit të muzikës. Lehtësuesi më pastaj u thotë diçka për muzikën: kush e ka krijuar, çka do të thotë teksti; pse është i rëndësishëm.

Nga përvoja e pjesëmarrësve më pastaj fillohet debati. Çka na mëson muzika si trashëgimi?

Shqyrtimi i idesë së dallimeve na ndihmon që të gjithë ne si genie njerëzore të lidhemi sepse muzika krijohet nga emocionet e përbashkëta njerëzore. Po ashtu, muzika stimulon aftësinë e të dëgjuarit.

Ndërlidhni aktivitetin me vendin që do ta vizitoni. Pse i jepni domethënie apo emocion të caktuar vendit specifik? Pse këtë nuk e bëni për ndonjë vend tjetër? Pse na nevojitet trashëgimia? etj.



SKENË NGA FILMI DOKUMENTAR "E KUJTT  
ESHTE KJO KËNGE?" NGA ADELA PEEVA



## Krijimi i sociogramit për të drejtat e njeriut dhe diversitetet – shfaqje

Pjesëmarrësit marrin shënime, ku përshkruhen profile të ndryshe të njerëzve nga shoqëria, p.sh.:

- Një 40 vjeçar, i racës së bardhë, i martuar dhe menaxher në një kompani që është e suksesshme në biznes për shumë vite me rradhë;
- Një 16 vjeçare romë, e pamartuar, që jeton me një prind dhe një fëmijë, nuk ka letërnjoftim (nuk është e regjistruar) dhe është e papunë;
- Një 18 vjeçare e racës së bardhë që jeton në një bashkësi rurale dhe patriarkale, e varfër dhe pa mundësi për shkollim;
- Një 30 vjeçar me aftësi të kufizuara dhe me paaftësi të vogël mendore;
- Një 73 vjeçare, që jeton vetëm dhe është pa pension;
- Një 27 vjeçar, me shkollë të lartë të kryer dhe me orientime homoseksuale.

Pjesëmarrësve u jepet kohë për të menduar për rolet e tyre dhe për të krijuar historinë e jetës së "tyre". Së pari, drejtuesi i ushtrimit u kërkon që të qëndrojnë afër njëri-tjetrit, duke formuar një rresht. Së dyti, drejtuesi kërkon nga çdo pjesëmarrës të tregojnë rrëfimin e vet të jetës.

Drejtuesi ka një listë pyetjesh që i referohen të drejtave themelore të njeriut, siç janë: e drejta për shkollim, shëndet, sigurim, lëvizje të lirë, shprehje të lirë të dashurisë, të drejta të femrave, etj. Ai shpjegon se në çdo pyetje përgjigja mund të jetë "Po" ose "Jo", dhe se duhet të jetë nga pikëpamja e personazhit që ata e luajnë. Nëse përgjigja është "Po" pjesëmarrësi bën një hap përpara, por nëse përgjigja është "Jo", atëherë ai shkon një hap prapa. Kur të jetë parashtruar pyetja e fundit, nga pozita përfundimtare mund të thuhet se pjesëmarrësit kanë formuar një 'grafik' me trupat e tyre, i cili qartazi tregon nëse rrethanat e tyre u kanë ndihmuar gjatë jetës apo ua kanë përkeqësuar atë, dhe mënyrën se si pozita e tyre ndërlidhet me pozitën e të tjerëve.

In preparation, the participants are asked to get inside these roles emotionally, and to sympathise with their characters. After the exercise, they are asked to describe their own feelings; to explain the differences and obstacles they themselves have come across in life, and their impact. They are then asked what could have been done differently and how much would be required by way of change in order to achieve this. Finally, they are asked what they could offer to their community, and why this is so important.

NB Ky ushtrim mund të shkaktojë kundërrëfime, dhe duhet të realizohet me kujdes. Gjatë diskutimeve në punëtori, disa menduan se disa pjesëmarrës mund të mos ndihen mirë, p.sh. dikush që nuk do të dëshironte të luante personazhin homoseksual apo dikush që vet është homoseksual dhe nuk do t'i pëlqente që homoseksualin t'a luajnë ata që nuk janë të tillë. Kështu që ideimi i ushtrimit duhet të konsiderohet si fazë e parë, ndërsa informata për ushtrimin duhet të jepet paraprakisht. Nëse grupi mendon se nuk dëshiron ta realizojë ushtrimin vet, atëherë në rregull: është me rëndësi të identifikohet arsyeja për një gjë të tillë, dhe kjo të diskutohet ngadalë. Kjo thjesht mund të ndodh për shkak se ata nuk janë të gatshëm dhe se ndoshta më vonë gjatë rrjedhës së lëndës do të mund ta merrnin parasysh një gjë të tillë.

## Shtëpia dhe familja

Diskutim: cilat janë përvojat e pjesëmarrësve për shtëpinë dhe familjen, posaçërisht në mjedise më tradicionale, siç janë fshatrat, ku kanë jetuar prindërit apo gjyshi dhe gjyshja?

A kanë ndonjë domethënie ajo trashëgimi dhe ato tradita për ta: a do t'i vazhdojnë ndonjërin prej tyre? Cilat? Pse?

Cili është qëndrimi i tyre për fillimin e familjes dhe si ndërlidhet kjo apo si dallon kjo nga përvoja

e të afërmve të tyre? A është e nevojshme të vazhdohet me respektimin e formës tradicionale të familjes?

### Promovimi i modulit

Hartim i modulit ka përfunduar, universiteti është pajtuar që ta realizojë, dhe tani moduli duhet të shpallet! Pjesëmarrësit duhet ta bëjnë një reklamë njëminutëshe televizive për modulin, e cila do të transmetohej në një stacion televiziv lokal. Audiencia e synuar janë të rinjtë. Secili grup duhet të krijojë një skeç dhe të gjithë pjesëmarrësit në grup duhet t'i shoshitin idetë, ku disa duhet të merren me organizim, disa me përgatitjen e skenës dhe disa të tjerë me aktrim.


Pjesëmarrësit do të kenë gjysmë ore në dispozicion për t'u përgatitur dhe pastaj klasa do të ketë edhe një gjysmë ore për ta parë aktrimin e "reklamave", dhe për të diskutuar rreth tyre. Nga vijuesit mund të kërkohet që këto t'i përgatisin paraprakisht.

### Shikimi i filmave

Filmi "Whose is This Song" (E kujt është kjo këngë) ka nxitur debat cilësor dhe është konsideruar të jetë më interesante. Po ashtu, filmi Baraka: i realizuar nga Ron Fricke dhe Mark Magidson. Do të mund të përdroreshin edhe shumë filma të tjerë dokumentarë për të ilustruar temat e ligjëratave dhe për të nxitur diskutim. Këta filma po ashtu do të mund të shfaqeshin gjatë mbrëmjeve, ku do të mund të vinin edhe studentë të tjerë dhe t'i bashkoheshin diskutimeve.



POSTERËT ZYRTARË TË FILMAVE "E KUJT ËSHTË KJO KËNGË" DHE "BARAKA"



---

## 9.2. KUIZET DHE LOJËRAT PËR AKTIVITETET E KONTAKTIMIT NË TERREN

### Krijimi i kuzit për trashëgimi

Në kuiz do të mund të përfshiheshin pyetjet për trashëgiminë ndërkombëtare apo për atë të Kosovës. Ky kuiz mund të ketë formatin e “kuzeve pub” të Mbretërisë së Bashkuar:

- 10 pyetje caktohen për secilën prej 6-8 kategorive të ndryshme. Zakonisht, këto kategori mbulojnë fusha të ndryshme, siç janë: gjeografia, sporti, filmi, muzika pop e viteve 1960-ta, shkenca, ushqimi dhe pijet, njerëzit, etj. Në këtë rast, ato pyetje duhet të jenë të orientuara kah trashëgimia, kështu që kategoritë do të mund të përfshinin vendet e trashëgimisë botërore, historinë, objektet, këngët, ushqimin, gjuhët, etj.
- Kuizi është konkurrues: pjesëmarrësit formojnë ekipet prej 4-6 anëtarëve: nëse kuizi do të mund të reklamohej paraprakisht, atëherë pjesëmarrësit do të kishin më shumë kohë për formimin e ekipeve. Ekipet duhet të emërtohen.
- Çdo ekip ulet bashkë në një tavolinë të ndarë në mënyrë që të diskutojnë për përgjigjet, por pa u dëgjuar nga ekipet e tjera;
- Çdo ekip merr një formular që plotësohet për çdo rreth të pyetjeve:

### RRETHI 1: VENDET E TRASHËGIMISË BOTËRORE

Pyetja nr.

Përgjigja

1

2

3

4 etj...

- Parashtruesi i pyetjeve lexon pyetjen 1, dhe u jep ekipeve një minutë për t'u përgjigjur; pastaj parashtron pyetjen 2 e kështu me radhë deri te pyetja 10. Në fund të çdo rrethi të pyetjeve, formularët mblidhen, rezultatet e çdo ekipi llogariten shpejtë dhe u komunikohen të tjerëve.
- Në fund, shpallet fituesi i përgjithshëm, ku ekipi fitues zakonisht merr një shpërblim, që shpesh mund të jetë venë apo birra.

NB Përpilimi i kuzit në vetvete është ushtrim i mirë: grupi mund të ndahet në grupe më të vogla, ku secili grup mund të përpilojë nga dhjetë pyetje. Këto pyetje mund t'i provojnë duke ia parashtruar njëri-tjetrit. Nëse u pëlqejnë pyetjet e tyre, atëherë në universitetin e tyre mund ta organizojnë një mbrëmje të kuzit (natyrisht, asnjëri prej tyre nuk mund të marrin pjesë në ekipe, pasi që i dinë pyetjet). Kjo do t'ishte mënyrë për tërheqjen e studentëve edhe nga fakultete e tjera dhe për këmbimin e njohurive.

## Krijimi i kompletit të letrave për lojë

Ky ushtrim në shikim të parë duket i thjeshtë, por nuk është i fillë. Nga pjesëmarrësit kërkohet që të zgjedhin 52 ilustrime për letra me qëllim të krijimit të një kompleti letrash që do të promovonte trashëgiminë në Kosovë. Nëse ushtrimi bëhet atypëraty në klasë, atëherë ilustrimet do të jenë imagjinare, dhe do të përshkruhen. Përndryshe, studentët do të mund të krijojnë një komplet të vërtetë ilustrimesh.

Ushtrimi i krijimit të kompletit të letrave nënkupton kufizimin e numrit në 52 letra (plus xhokeri!). Këtu ofrohet mundësia e 4 letrave me ilustrime të njëjta apo e 53 letrave me ilustrime të ndryshme. Në fakt, ky është ushtrim i inventarizimit që nuk është aq i thjeshtë sa duket. Çka duhet të përfshihet dhe në çfarë përmasash? A përfshihet trashëgimia materiale dhe jomateriale, dhe si përfaqësohet ajo? A duhet të siguroheni që vendi të përfaqësohet në mënyrë të barabartë sipas kriteve gjeografike, historike, natyrore apo kulturore ose sipas të gjitha këtyre kriteve? Natyrisht se nuk ekziston një përgjigje e vetme e saktë: rezultat i rëndësishëm është që grupi i angazhuar në ushtrim në fund duhet të jetë në gjendje t'ua shpjegojë vendimet e veta të tjerëve.

## Loja gjarpëri dhe shkallët/kuiz trivia

Loja gjarpëri dhe shkallët është një lojë e vjetër antike, me prejardhje nga India. Sikurse loja Ludo, është e thjeshtë për t'u luajtur, lojtarët lëvizin përmes hedhjes së zarit dhe përparojnë në ngjitjen e shkallëve lartë apo shkojnë poshtë drejt gjarpërinjve. Kjo lojë për shumë vite me rradhë ka qenë shumë e popullarizuar tek fëmijët në Mbretërinë e Bashkuar. Në Kosovë duket se nuk e njohin. Pra, duke marrë parasysh prejardhjen indiane të saj, këtu shohim elemente të risisë dhe të diversitetit kulturor.

### **Shih:**

[http://en.wikipedia.org/wiki/Snakes\\_and\\_Ladders](http://en.wikipedia.org/wiki/Snakes_and_Ladders)

Versioni i thjeshtë (i zakonshëm) mund të luhet në internet, shih:

[http://www.helpkidzlearn.com/games/snakes\\_and\\_ladders/snakes\\_and\\_ladders.shtml](http://www.helpkidzlearn.com/games/snakes_and_ladders/snakes_and_ladders.shtml)

Studentët po ashtu mund të inkurajohen të krijojnë një variant të lojës, p.sh.: lojtarët duhet t'i përgjigjen një pyetjeje para se ta hedhin zarin, dhe nëse përgjigja është e gabuar, nuk mund ta hedhin. Pyetjet duhet të përpilohen në atë mënyrë që të jenë të përshtatshme për moshën e caktuar të fëmijëve (apo të të rriturve), për të cilët loja është e paraparë, ku tematika e saj mund të jetë trashëgimia.


Kjo lojë mund të përdoret në shkolla apo mund të jetë si dhuratë për miqtë ose familjen. NB nëse planet për krijimin e lojës merren nga interneti (si më lartë), atëherë ato nuk mund të shiten.

Koleksion portativ i lojërave tradicionale në karton dhe lojërave të tjera

Këto lojëra mund të parashihen për t'u marrë në shkolla. Ato duhet të jenë lojëra që tradicionalisht janë luajtur në shkolla apo në shtëpi dhe ndoshta kanë filluar të zhduken, si dhe janë të njohura vetëm në vendet e caktuara në Kosovë.

Të shfrytëzohen si mjet për biseda rreth trashëgimisë jomateriale, kënaqësive të përbashkëta dhe trashëgimitë të përbashkëta. Kjo do të jepte mundësinë e ndarjes së përbashkët të trashëgimisë dhe mund të përdoret për hapjen e diskutimeve për lojërat e tjera që nxënësit apo mësuesit dinë, për atë se cila është prejardhja e tyre dhe çka nënkuptojnë në aspektin e trashëgimisë dhe të vazhdimësisë. what they mean in terms of heritage and continuity.

---





## 10. VIZITAT NË TERREN

### 10.1. ZGJEDHJA E VENDEVE

Nuk duhet të lejojmë që fjala “vend” t’na çorientojë: vizitat duhet t’u japin student[ve rastin për të parë sa më shumë lloje të trashëgimisë që të jetë e mundur, ku këtu mund të përfshihet trashëgimia jomateriale dhe jo vetëm monumentet fizike apo peizazhet, p.sh. mënyra të ndryshme tradicionale të jetesës, praktika fetare, punë dore dhe praktika të tjera shtëpiake.

Zgjedhja e vendeve për t’i vizituar duhet të bëhet çdo vit, dhe përzgjedhja do të varet nga koha dhe financimi.

### 10.2. VIZITAT

Rekomandohet që:

- Vizitat të organizohen gjatë fundjavave pasi që për to nevojiten disa orë; më së miri do të ishte që të ndahet një ditë e plotë për to në mënyrë që të shihen disa vende.
- Profesorët duhet t’i shmangen organizmit të vizitave gjatë dimrit pasi që moti shumë i ftohtë dhe i lagësht kufizon kohën që studentët do të kishin dëshirë të kalonin, duke i studiuar vendet e trashëgimisë.
- Studentëve paraprakisht duhet t’u jepet materiali për lexim që është relevant për vendet e vizituara në formë të një pakoje informuese dhe duhet t’u tregohet se çka do të pritet nga ata me rastin e ardhjes në vendin e trashëgimisë në aspektin e grumbullimit të informatave, bërjes së fotografive, pra, vizitat duhet të shfrytëzohen më së miri në mënyrë që të mos kenë vetëm aspektin turistik.
- Duhet të bëhet përzgjedhje e kujdesshme lidhur me ciceronët, në rast se nevojitet shërbimi i tyre. Më së mirë do të ishte që profesori paraprakisht të jetë i përgatitur që të mos ketë nevojë për ciceron. Nëse profesori luan rolin e ciceronit, atëherë kjo do t’ua mundëson studentëve që të përfitojnë më shumë nga vizita sesa nga informatat turistike (të cilat veç se duhet të jenë në pakon informuese), pasi që profesori do t’i nxisë ata që të parashtrajnë më shumë pyetje.
- Gjatë ditës duhet të rezervohet koha edhe për reflektim dhe diskutim.

### 10.2.1. Pyetëtori për vizita në vendet e trashëgimisë

Pyetëtori mund të përdoret si mënyrë për grumbullimin e informatave dhe ideve gjatë çdo vizite në terren: gjatë qëndrimit në vendin e trashëgimisë duhet të merren shënime dhe ndoshta një gjë e tillë do të duhej të bëhej edhe menjëherë pas vizitës. Pyetëtori duhet të shtypet dhe të shpërndahet si pjesë e pakos informuese për studentë për atë ditë. (NB do të ketë nevojë të zgjerohet për të pasur më shumë hapësirë për shkrim.)

Ky proces merr shumë kohë, dhe formulari është më i përshtatshëm për ndonjë vizitë, ku shihen një apo dy vende të trashëgimisë. Ky formular po ashtu mund të përdoret si pjesë e një projekti më të madh për të kuptuar një vend të caktuar.

Shënimet e marra mund të përdoren në sesionin përfundimtar të diskutimeve, me rastin e shqyrtimit të vizitave në teren. Këto shënime do t’u ndihmojnë pjesëmarrësve për të identifikuar:

- Vlerat e përfaqësuar nga ai vend në kohën e tanishme dhe në të kaluarën
- Reagimet që ata individualisht mund të kenë pasur për çdo vend të trashëgimisë
- Arsyet për mënyrat e ndryshme, përmes së cilave vendet e trashëgimisë menaxhohen dhe paraqiten.



# PYETËSORI PËR VIZITAT NË VENDET E TRASHËGIMISË DHE TË DIVERSITETIT

## 1. LLOJI I VENDIT TË TRASHËGIMISË:

1.1 Shkurtimeisht përshkruani se çka përbën vendin e trashëgimisë, p.sh. kështjellë gotike e shekullit 14h , me një kupolë të shtuar në shekullin e 18-të, e cila gjendet në një hapësirë prej 10 ha, me drunj të vjetër dhe me liqe.

## 2. VLERAT: Cilat janë vlerat që bëjnë këtë vend të rëndësishëm?

2.1 Historike

2.2 Arkeologjike

2.3 Arkitekturore

2.4 Estetike

2.5 Të atmosferës / ndjenja e vendit

2.6 Shpirtërore (kjo nuk vlen vetëm për objektet fetare)

2.7 Të komunitetit

2.8 Rekreative

2.9 Natyrore / ekologjike

2.10 Politike (vend i pushtetit, ideve politike, konfliktit politik)

2.11 Të identitetit (për individë, komunitetin lokal, komunitetin më të gjerë, kombin)

2.12 Asociative (diku ku ju apo të tjerët asocioheni me njerëz, ngjarje apo kujtime)

2.13 Ekonomike (ndikimi në ekonominë lokale, regjionale apo shtetërore)

2.14 Arsimore

2.15 Të tjera?

Vendosni se si do t'i rendisni këto vlera personalisht: mendimi juaj nuk do të duhej ndikuar nga ajo se çka keni mësuar apo nga ajo se çka të tjerët mendojnë. Pastaj, krahasojeni atë me mendimet e pjesëmarrësve të tjerë. Ka shumë gjasa dhe është e natyrshme që idetë e juaj do të dallojnë, dhe se ju mund të mësoni të vlerësoni apo të kuptoni asketet e vendit të trashëgimisë, duke bërë krahasimin e ideve. Po ashtu mund të kuptoni se disa vlera thjeshtë shkojnë në kundërshtim njëra me tjetrën, dhe se edhe kjo është normale.

## 3. NJOHURIA

3.1 A është hulumtuar dhe kuptuar mirë vendi i trashëgimisë kulturore?

3.2 Nëse jo, çka mungon?

3.3 A janë kuptuar të gjitha periudhat e historisë së vendit të trashëgimisë, apo ka pasur koncentrim në një periudhë të caktuar?

3.4 Nëse është kjo e fundit, cilat është arsyeja?

---

3.5 A mund të ndryshojnë të kuptuarit/gëzimi/reagimet, duke hulumtuar periudhat më pak të njohura?

#### 4. PALËT ME INTERES

---

4.1 Për kë është ky vend i rëndësishëm?

---

4.2 Si do ta përshkruani komunitetin lokal? NB A përbehet nga grupe të ndryshme?

#### 5. QASJA

---

5.1 A është vendi i hapur për qytetarët?

---

5.2 Cili është orari i punës?

---

5.3 A ka qasje në të gjitha pjesët e vendit për të gjithë mysafirët/ shfrytëzuesit e vendit?

---

5.4 Nëse jo, cila është arsyeja?

#### 6. SHFRYTËZIMI

---

6.1 Si shfrytëzohet vendi? NB Shfrytëzimi mund që fare të mos ketë lidhje me vlerat e trashëgimisë apo me turizëm: vendi mund të shfrytëzohet nga fëmijët sepse nuk kanë ndonjë vend tjetër për t'u takuar; një vend i mirë mund të shfrytëzohet nga njerëzit për të shëtitur qentë e tyre; kisha mund të përdoret nga pikturuesit apo edhe nga njerëzit që vinë aty vetëm për të gjetur një vend të qetë për të menduar.

---

6.2 A janë ndryshuar mënyrat e shfrytëzimit të vendit me kalimin e kohës? Si?

---

6.3 A ka dëshmi për këtë?

---

6.4 A mund që shfrytëzimi të ndryshon përsëri?

#### 7. PRONËSIA DHE MENAXHIMI

---

7.1 Kush është pronar i vendit?

---

7.2 Cilat agjenci /grupe / individë menaxhojnë vendin?

---

7.3 Cili është interesimi i tyre i veçantë në menaxhimin e vendit?

---

7.4 A është i përfshirë komuniteti lokal në ndonjë mënyrë në kujdesin apo në menaxhimin e vendit?

---

7.5 Si ndikon pronësia/menaxhimi në mënyrën e prezantimit të vendit, gjegjësisht a kufizohet ajo se çka lejohet të shihet/të dini/të kuptoni/të kënaqeni?

---

7.6 Si mund të ndryshojë apo të përmirësojë pjesëmarrja e rritur lokale mënyrën e menaxhimit të vendit?

#### 8. GJENDJA

---

8.1 Në çfarë gjendje është vendi?

---

8.2 Si ndikon kjo në mënyrën e ndërlidhjes suaj me të?

#### 9. KONSERVIMI

---

9.1 A ka pasur ndonjë ndërhyrje konservimi? Çfarë?

---

9.2 A janë kryer këto ndërhyrje me kujdes dhe me etikë?

---

---

9.3 Si e kanë ndryshuar vendin ato?

## 10. AUTENTICITETI

---

10.1 Lidhur me këtë vend, çka mendoni se është autentike për të? NB Autenticiteti mund të nënkupton jo vetëm materialin, por edhe ndjenjën emocionale dhe të vendit.

---

10.2 Nëse ky autenticitet gjendet në materialin më të ri, pse ndodh kështu?

---

10.3 A duhet të hiqen shtesat e mëvonshme për ta kthyer objektin në gjendjen e tij autentike?

---

10.4 Gjatë këtij procesi, a mund të jemi në rrezik të bërjes së gjykimeve për vlerat, për të cilat të tjerët në të ardhmen mund të mos pajtohen?

---

10.5 Ose, a janë ndërtimet e fazave të mëvonshme po ashtu autentike në vetvete? P.sh shtesat e shekullit 18-të në objektin e shekullit të 16-të janë autentike në vetvete, dhe se kjo periudhë në fakt mund të jetë faza më e rëndësishme e zhvillimit të atij objekti.

## 1. INTERPRETIMI

---

11.1 A ka ndonjë material interpretimi në atë vend (njofitime, fletushka, libra)?

---

11.2 A ka ciceron në dispozicion?

---

11.3 Si do ta vlerësonit cilësinë e interpretimit?

---

11.4 Çka ju ka mësuar interpretimi?

---

11.5 A duhet që interpretimi të jetë më i ndërlikuar, shumështrësor dhe në çfarë mënyre?

---

11.6 A duhet që komuniteti apo komunitetet vendore të përfshihen në zhvillimin e interpretimit të vendit të trashëgimisë?

---

11.6 Çka do të fitohej?

## 12. PERCEPTIMET

---

12.1 A janë ndryshuar perceptimet për vendin me kalimin e kohës?

---

12.2 Nëse po, në çfarë mënyre?

## 13. KUJTIMET

---

13.1 A është e rëndësishme të regjistrohen dhe të kuptohen kujtimet e njerëzve lidhur me vendin?

---

13.2 Çka nëse ato kujtime janë traumatike?

---

13.3 A duhet të harrohen kujtimet traumatike dhe që vendi të “neutralizohet” sa më shpejtë që të jetë e mundur?

---

13.4 A është kjo në fakt e mundur apo a ngërthen në vete rreziqe?

## 14. VIZITAT NË TË KALUARËN

---

14.1 A e keni vizituar këtë vend më parë?

---

14.2 Nëse jo, cila ka qenë arsyeja?

## 15. VIZITAT NË TË ARDHMEN

---

15.1 A do të vinit përsëri?

---

15.2 Pse?









